



Shënime mbi plotësimin e FORMULARIT të KËRKESËS PËR JO-PRONËSI NË PROCESIN E RIORGANIZIMIT

1. HYRJE

Shënimet në vijim janë ofruar për të asistuar ankuesve për plotësimin e Formularit të Kërkesës për Riorganizim e jo-pronësisë (R25a Dëshmi e kërkesës). Nëse keni dyshim për çfarëdo aspekti të ankesës suaj, fuqimisht këshilloheni të kërkonit këshillë dhe asistencë të pavarur ligjore. Asistenca e tillë nuk mund të ofrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ju lutem vëreni posaçërisht që formulari i kërkesës duhet të nënshkruhet. Faket dhe kopjet do të pranohen mirëpo Administratori mban të drejtën të kërkojë origjinalin në çdo kohë.

Formulari i kërkesës përdor referencën e njëjtë siç është përdorur në nenin 34 të Ligjit për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre dhe është përcaktuar sipas dispozitave të nenit 17.4 të ligjit të njëjtë.

1.1 EMRI I NDËRMARRJES SHOQËRORE

Emri i Ndërmarrjes shoqërore është e rëndësishme të shënohet, pasi që vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohet dhe kërkesa e juaj mund të bëhet e mundshme pas shqyrtimit nga Administratori.

1.2 EMRI DHE ADRESA E ANKUESIT

ANKUESI është personi fizik dhe ligjor i cili pretendon kundër Ndërmarrjes në Pronësi Shoqërore.

Nëse jeni person fizik ju lutem në këtë kuti shkruani emrin tuaj të plotë, adresën postare dhe numrat kontaktues të telefonit, fiks dhe mobil nëse është e mundur.

Nëse jeni person ligjor ju lutem shkruani emrin e regjistruar (dhe çfarëdo emir alternative) regjistruar në adresë postare, numër telefoni dhe emër të personit kontaktues.

2. ANKESAT E SIGURUAR DHE PENGJET; HIPOTEKAT DHE KOLATERALET TJERA

Vendos [X] në kutinë e duhur nëse ankesa e juaj është ankesë/kërkesë e siguruar. Përshkruaj natyrën e kërkesës kur dhe si kërkesa është parashtruar dhe raportet e hollësishme të çfarëdo kolaterali të mbajtur, vlera e kolateralit të tillë, data është dhënë dhe detajet e çfarëdo regjistrimi ose (pengu, hipoteke, etj). Vendose ndaras vlerën e kolateralit, borxhin parimor, interesin e akumuluar dhe/ose ndëshkimet që janë të zbatueshme sipas kontratës ose ligjit.

Përmende dhe ofro dëshmi ku kërkesat e siguruar janë regjistruar dhe datat e regjistrimit.

Ju lutem ofroni (dokumente shtesë) detaje të mjaftueshme të aseteve në të cilat pengjet/hipoteka është pretenduar (kontrata valide, lokacioni fizik etj.) në mënyrë që të jetë

fizikisht i identifikuar. Në është e mundshme, gjithashtu dorëzo vlerësimin e vlerës individuale të secilit aset.

Bashkangjiti kopjet e kontratave të dhëna nga Ndërmarrja që dëshmojnë hipotekë ose kolektoral dhe gjithashtu identifikoj asetet e dhëna si siguri për shumën e pretenduar.

2.1 LLOJI(ET) DHE SHUMA(T) E KËRKESËS (KËRKESAVE)

Përzgjedh llojet që korrespondojnë më së afërmi me kërkesat që janë bërë dhe shkruaj shumën e përgjithshme të pretenduar për secilin lloj (p.sh. disa fatura për mallra) bashkangjit një listë të ndarë që identifikon artikujt individual, vlerat e tyre dhe totali siç është shkruar në formular. Nëse nuk është e mundur në të gjitha rastet një shifër e saktë, atëherë një shifër e vlerësuar dhe përshkruan atë si vlerësim.

Cakto shumën e interesit ndaras nëse zbatohet në kërkesën tuaj, në përputhje me nenin 31.3 të Ligjit mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre. Ofro detajet se si është llogaritur norma e interesit dhe ofro dëshmi për bazën ligjore të kësaj llogaritje.

Nëse shuma nuk është në EURO, shkruaj valutën në të cilën është parashtruar kërkesë. Nëse kërkesa është dorëzuar në euro bazuar në transformimin e kërkesës tjetër të valutës, ofro detajet e normës së valutës së përdorur, data, burimet dhe detajet e llogaritjes. Nëse shuma e pretenduar është në Euro bazuar në vlerën e faturës ose dokumentet tjera mbështetëse, ju lutem plotësojeni vetëm shumën në Euro.

3. KËRKESAT PËR MARRËDHËNIET E PUNËS

Të drejtat e punëtorëve të NSH-së në Riorganizimin e AKP-së Meriton elaborim shtesë:

3.1 Punëtorët e një NSH-je në riorganizim mund të parashtrojnë kërkesë për të drejtat e tyre sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të 9 maj 2003 mbi Transformimin e të drejtës për shfrytëzimin e pronës shoqërore, vetëm nëse plani për riorganizim përmban privatizimin e njësisë në të cilën ata janë caktuar të punojnë nga kontrata e tyre e punës me NSH-në. Në rast se NSH-ja është riorganizuar pa u privatizuar, kërkesat e tilla janë të pazbatueshme.

3.2 Ish punëtorët mund të parashtrojnë kërkesë për pagesë të pagave të papaguara nga Ndërmarrja Shoqërore. Kërkesa mund të përfshij vlerën monetare dhe numrin e pagave të papaguara. Vlera monetare e tri pagave bruto të papaguara për punën e kryer para vendimit për moratorium do të kategorizohen si pagesë me prioritet për efekt të shkallës së prioritetit të pagesës sipas nenit 34.1.3 të ligjit mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre. Vlera teprice e kërkesës së miratuar duhet të klasifikohet si kërkesë për pagesë dhe jo-prioritet i pasiguar sipas nenit 34.1.5 i ligjit mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre.

Vlera bruto e kërkesës duhet të përfshij tarifën e autoriteteve tatimore dhe fondet pensionale bazuar në dispozitat e tatimit mbi të ardhurat personale dhe ligjet e pensionit si dhe titullohet pagesë e favorizuar për Administratën Tatimore dhe Fondin Pensional.

4. KËRKESAT E PASIGURUARA PËR TATIMET DHE BORXHET TJERA NDAJ AUTORITETEVE PUBLIKE

Kërkesat e pa siguruara në Administratën Tatimore të Kosovës bazuar në tatimet në qira, tatimet e supozuara, tatimet mbi korporatë, tatimet e të ardhurave personale dhe tatimi mbi vlerën e shtuar përfshirë edhe tatimin e pronës borxh ndaj komunave duhet të pohohet në shumën e tij të përgjithshme dhe ndaras për interesin dhe ndëshkimet. Këto pretendime duhet të renditen sipas nenit 34.1.4 të ligjit mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre.

5. KËRKESAT E PASIGURUARA

Çfarëdo kërkesë e pasiguar në likuidim duhet të parashtrohet duke vendosur [X] në kutinë e duhur të llojit të kërkesës p.sh. "Furnizuesit Vendor" ose "Rryma" për kërkesë të KEK-ut. Parashtruesit e kërkesës duhet të jenë të sigurt që ata kanë ofruar detajet për shumën e kërkesës së tyre si dhe ndaras interesin e zbatueshëm dhe bazën ligjore të llogaritjeve të tij. Nëse aplikacioni i juaj nuk mund të kategorizohet në çfarëdo lloji të kutive përkatëse, atëherë shënoni kutinë "Kërkesat-tjera". Ju lutem ofroni detajet shtesë në shkresë të çfarëdo kërkesë kundër ndërmarrjes.

5. DOKUMENTET MBËSHTETËSE

Këtu shkruaj një përmbledhje të dokumenteve që do të bashkëngjiten formularit në mbështetje të aplikacionit tuaj. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të vendosur të gjitha dokumentet e bashkangjitura, ju lutem përdoreni një fletë tjetër shtesë.

MOS DËRGO DOKUMENTET ORIGJINALE – bashkëngjiti vetëm kopjet që i keni vërtetuar si kopje të vërteta të dokumenteve origjinale me të cilën bazohet kërkesa e juaj.

6. DEKLARATA E SË VËRTETËSISË

Ju lutem siguroni që kjo deklaratë është plotësuar. Shkruaj emrin e parashtruesit të kërkesës (personi fizik/ligjor),. Nëse kërkesa është bërë nga personi u autorizuar në emër të parashtruesit të kërkesës, personi i autorizuar duhet të nënshkruaj formularin poashtu. Autorizimi i verifikuar ligjërisht duhet të bashkëngjitet formularit. Përfundimisht, nënshkrimet duhet të jenë origjinale të shkruara me dorë.

Vërejtje: Çdo person i cili me dashje parashtron kërkesë që është falso dhe mashtrues mund të përndjeket penalisht.